V E N D I M
Nr. 115, datë 18.3.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË PERSONELIT QË DO TË AKTIVIZOHET PËR PASTRIMIN DHE ASGJËSIMIN E MUNICIONEVE E EKSPLOZIVAVE.

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës se Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.7498, datë 26.7.1995 "Për forcat e armatosura në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 9 të ligjit

V E N D O S I:

1. Në strukturën organike të Ministrisë së Mbrojtjes, në përbërje të drejtorisë operative, krijohet dega e asgjësimit të municioneve dhe eksplozivave me një numër organik punonjësish prej 3 (tre) oficerësh.

2. Ministria e Mbrojtjes të marrë masat e nevojshme organizative për shtrirjen e hallkave të tjera të strukturës, që pastrimi e asgjësimi i municioneve të kryhet në ushtri dhe në shkallë vendi.

3. Numri i punonjësve të degës së asgjësimit të municioneve dhe eksplozivave, të përballohet brenda numrit organik të përcaktuar për ushtrinë për vitin 1999.

4. Ushtarakët aktivë, që do të merren me ç'aktivizimin e asgjësimin e municioneve dhe eksplozivave të trajtohen në masën deri 300 për qind shtesë page mbi pagën bazë mujore, për natyrë të veçantë pune e shërbimi.

5. Përfitojnë nga kjo shtesë mbi pagën bazë dhe ushtarakët aktivë që do të aktivizohen dhe mbështesin strukturën e asgjësimit të municioneve dhe eksplozivave për aq orë pune sa janë angazhuar në këtë veprimtari.

6. Kriteret dhe masa e shpërblimit përcaktohet nga Ministri i Mbrojtjes.

7. Ushtarakët që trajtohen me këtë vendim, nuk përfitojnë shtesën mbi pagën bazë për vështirësi vendi e shërbimi sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.60, datë 27.2.1992.

8. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 1999 në zërin "Paga", i shtohen 4 600 000 (katër milionë e gjashtëqindmijë) lekë, të cilat përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko